

Tiranë më, 31/05/2024

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE
“TREV PHARMA”**

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA, KAPITALI**

**NENI 1
THEMELIMI DHE TË DHËNAT INDENTIFIKUESE TË THEMELUESIT**

1.1 Themeluesi me vullnetin e tij te lire, për arritjen e objektivave ekonomike, duke dhene kontributin e tij ka krijuar një shoqeri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**TREV PHARMA**” e cila krijohet dhe funksionon sipas legjislativit shqiptar.

1.2 Themeluesi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është:

- **Z.nj ARJOLA IBRO**, shtetase shqiptare, atësia Resul, lindur ne Vendrashe me date 07/11/1989, banues në Tiranë, ne “Rr.ali progori, ndertesa 13, hyrja 1, ap1, njesia administrative 9, 1016 Tirane, madhere e me zotesi te plote juridike per te vepruar me nr. Personal I96107043E,

**NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

2.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është i posaçëm “Shitja e përgatitja e artikujve farmaceutike në dyqane të specializuara”.

**NENI 3
KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është pa afat.

**NENI 4
SELIA E SHOQËRISË**

4.1 Selia e shoqerise / Zyra qendrore ndodhet brenda territorit te Republikës se Shqipërisë ne Adresen: Tiranë, Rr. " Musline Kokalari, prane shkolles 'Musine Kokalri', hyrja 1.kati 1,Apartamenti Nr.1 Kombinat", Tirane.

NENI 5 **KAPITALI I SHOQËRISË**

5.1 Kapitali i ortakeve te shoqerise eshte i shprehur ne monedhen Leke. Ortaku i vetem ka vendosur qe kapitali i nenshkruar i saj te jete 100 000 (njeqind mijë) Leke, i ndare ne 1 kuote ne vleren 100 00 Leke.

5.2 Pjesmarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshte:

- Ortaku themelues Z.nj Ariola Ibro eshte kontribues ne vleren 100 000 Leke dhe si rrjedhim zoteruese e 1 kuote me vleren 100 000 Leke qe perben 100% te kapitalit te regjistruar te shoqerise.
- Ortaku themelues deklaron se do te shlyej kapitalin e regjistruar brenda 30 diteve nga hartimi i ketij statuti duke e depozituar ate ne llogarine bankare te hapur ne emer te shoqerise se krijuar.

NENI 6 **MODALITETET E ZMADHIMIT, ZVOGLIMIT DHE TRANSFERIMIT TË KAPITALIT**

6.1 Kapitali zmadhohet ose zvogelohet kur ploteson kushtet ligjore dhe duke ndjekur procedurat e parashikuara ne ligj ne momentin e vendosjes se zmadhimit ose zvogelimit te tij.

6.2 Kuota e shoqerise transferohet sipas parashikimeve te ligjit duke u marre me pare miratimi i Asamblese se shoqerise.

KREU II

ORGANET VENDIMARRËSE/DREJTUESE/ADMINISTRUESE

NENI 7 **ORGANI VENDIMARRËS I SHOQËRISË**

7.1 Organi i vetem vendimarres i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e ortakeve.

7.2 Asambleja e ortakeve mblidhet mblidhet sa here eshte e nevojshme per mbarevajtjen e shoqerise por jo me pak se 3 here ne vit

7.3 Asambleja e ortakeve eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) Ndryshimet e statutit
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjen b te kesaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

7.4 Te gjitha vendimet e marra nga ortaktu i shoqerise regjistrohen ne register te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- c) Investimet
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

NENI 8 **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

8.1 Te dhenat e indentifikimit te administratorit te Shoqerise:

Z.nj ARJOLA IBRO, shtetase shqiptare, atesia Resul, lindur ne Vendrashe me date 07/11/1989, banuese, Rr.'Ali Progori,ndertesa 13,hyrja 1,ap1,njesia administrative 9, 016 Tirane, , madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me nr. Personal I96107043E

NENI 9 **EMËRIMI, SHKARKIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT**

9.1 Administratori i shoqerise emerohet me vendim unanim te asambles se ortakeve per një periudhe **5 – vjeçare me te drejtë ripërtëritje**. Shkarkimi i administratorit behet me vendim unanim te asambles se ortakeve

9.2 Administratori ka keto kompetenca:

- a) Te kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Te perpiloje dhe nenshkruaje kontratat dhe aktet juridike qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise.
- c) Te hapi llogari rrjedhese bankare prane bankave shqiptare ose te huaja.
- d) Te perfaqesoje shoqerine ne marrdhenie me te tretet.
- e) Te emerojne nepunes te rangjeve te ndryshme per veprime te veçanta teknike ose per një kategori te caktuar veprimesh.
- f) Te përfaqësojnë shoqërinë tregtare ne marredhenie me te tretet;

- g) Te kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- h) Te përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- i) Te krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- j) Te kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- k) Te raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- l) Te beje gjithçka tjeter qe konsideron te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me formen e ketij Statuti e te Akitit Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi, per te arritur qellimin dhe objektin e shoqerise.

NENI 10
BAZA LIGJORE

10.1 Shoqeria eshte krijuar dhe do te vazhdoje veprimtarin ekonomike ne perputhje te plotë me kete statut dhe dispozitat ligjore te legjislacionit shqiptar.

10.2 Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, legjislacioni Tatimor dhe cdo ligj tjeter specifik qe lidhet me aktivitetin e shoqerise.

NENI 11
MOSMARRËVESHJET

11.1 Per mosmarreveshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi i ketij statuti si dhe per mosmarreveshjet midis shoqerise dhe te treteve do te jete kompetente Gjykata Shqiptare, sipas legjislacionit ne fuqi.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
TREV PHARMA SHPK**

ARJOLA IBRO